



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2023:027639
Datë: 09.10.2024
Numri i dokumentit: 06272881

Ac.nr.6798/23

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË, në kolegjin e përbërë prej gjyqtarëve Arsim Hamzaj - kryetar i kolegjit, Naime Ahmeti dhe Malsor Kryeziu - anëtarë të kolegjit, në çështjen juridike kontestimore të paditëses F.V., nga fshati..., komuna e Prizrenit, të cilën me autorizim e përfaqësojnë B.K. dhe F.G., të dy avokatë nga Prizreni, kundër të paditurës Komuna e Prizrenit - Drejtoria Komunale e Arsimit në Prizren, me objekt të padisë kompensimin e shpenzimeve të ushqimit për ditët e pranisë në punë - shujtat ditore, duke vendosur lidhur me ankesën e të paditurës të parashtruar kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prizren - departamenti i përgjithshëm, C.nr.302/23, të datës 28.07.2023, në seancën e kolegjit, të mbajtur më datën **03.10.24** mori këtë:

A K T G J Y K I M

REFUZOHET e pathemeltë ankesa e të paditurës Komuna e Prizrenit - Drejtoria Komunale e Arsimit, ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prizren - departamenti i përgjithshëm, C.nr.302/23, i datës 28.07.2023, **VËRTETOHET**.

A r s y e t i m

Gjykata e shkallës së parë me aktgjykimin e atakuar C.nr.302/23, të datës 28.07.2023, e ka aprovuar në tërësi si e bazuar kërkesëpadinë e paditëses F.V. nga fshati..., komuna e Prizrenit, dhe e ka detyruar të paditurën Komuna e Prizrenit - Drejtoria Komunale e Arsimit në Prizren, që paditëses F.V., nga fshati..., komuna e Prizrenit, në emër të shujtave ditore për 100 ditë pune (për periudhën prej datës 01.01.2022 deri më datën 31.08.2022), t'i paguaj shumën e përgjithshme prej 200.00 (dyqind) euro, me kamatë ligjore prej 8% në nivel vjetor, e cila fillon të rrjedhë nga data e paraqitjes së padisë 31.01.2023, e deri në pagesën definitive, të gjitha këto në afat prej 7 ditësh, pas pranimit të këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarimit të detyrueshëm, si dhe t'ia kompensojë shpenzimet e procedurës kontestimore në shumë prej 124.00 (njëqind e njëzetë e katër) euro, në afat prej 7 ditësh nga pranimi i këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarimit të detyrueshëm

Kundër këtij aktgjykimi e paditura në afatin ligjor ka parashtruar ankesë për shkak të *shkeljes së dispozitave të procedurës kontestimore, konstatimit të gabuar të gjendjes faktike dhe*

zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që Gjykata e Apelit ta aprovojë ankesën e të paditurës, aktgjykimin e goditur ta prish dhe të hedhë padinë e paditëses, apo të ndryshojë aktgjykimin e goditur ose të prish aktgjykimin dhe çështja t'i kthehet gjykatës së shkallës së parë në rigjykim.

Gjykata e Apelit si gjykatë e shkallës së dytë, pas vlerësimit të pretendimeve ankimore lidhur me aktgjykimin e atakuar, e në mbështetje të nenit 194 dhe 195 dhe 200 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), ka gjetur se:

- Ankesa e të paditurës është e pathemeltë.

Nga shkresat e lëndës rezulton se paditësja, përmes përfaqësuesve të autorizuar, me datën 31.01.2023, në gjykatën e shkallës së parë ka ushtruar padi kundër të paditurës Komuna e Prizrenit-Drejtoria Komunale e Arsimit, në Prizren, me objekt të padisë kompensimin e shujtave, vlera e kontestit 200 euro, me arsyet si në padi.

Gjykata e shkallës së parë duke vepruar sipas padisë, pa shqyrtim kryesor të çështjes, ka nxjerrë aktgjykimin e atakuar C.nr.302/2023, të datës 28.07.2023, me të cilin ka vendosur më decidivisht si në dispozitiv të tij. Në arsyetimin e aktgjykimit të atakuar, gjykata e shkallës së parë, ka arsyetuar se nga parashtrimet e palëve ndërgjyqëse të paraqitura në padi dhe në përgjigjen në padi, gjykata ka gjetur se nuk ishte kontestuese se paditësja është në marrëdhënie pune te e paditura, përkatësisht mësimdhënës në SHFMU "Mushnikova", në Mushnikovë, komuna e Prizrenit, fakt i cili vërtetohet me anë të vërtetimit me numër të referencës 37/2023, të datës 17.01.2023, të lëshuar nga drejtori i shkollës të SHFMU "Mushnikova", në Mushnikovë. Kontestuese nuk ishte as prania e paditësit në punë, ku nga vërtetimi nr.37/2023, të datës 17.01.2023, i lëshuar nga e paditura, konstatohet se paditësi prej datës 01.01.2022 deri me datën 31.08.2022, ka gjithsej 100 ditë të pranisë në punë, e po ashtu kontestuese nuk ishte po ashtu rrethana se e paditura nuk ka bërë kompensimin e shpenzimeve të ushqimit në punë. Lidhur me mënyrën e vendosjes gjykata e shkallës së parë ka vendosur se duke ju referuar dispozitës së nenit 35 paragrafi 7 të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë të datës 22.01.2021. Vendimin mbi kamatën e ka mbështetur në nenin 382 të LMD-së, ndërsa vendimin për shpenzimet e ka bazuar në nenin 449, 452 dhe 452.2 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (*më gjerësisht si në arsyetim të aktgjykimit të atakuar*).

Gjykata e Apelit e aprovon në tërësi vlerësimin juridik të gjykatës së shkallës së parë si të rregullt dhe të ligjshëm sa i përket vendosjes si në dispozitiv të aktgjykimit të atakuar, për arsye se i njëjti nuk është përfshirë me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore të pretenduara, dhe as në shkeljet nga neni 182 parag.2, pika b), g), j), k) dhe m), të LPK-së, dhe rrjedhimisht nuk ka aplikim të gabuar të së drejtës materiale për të cilat gjykata kujdeset sipas detyrës zyrtare sipas nenit 194 të LPK-së.

Nuk qëndrojnë pretendimet ankimore të të paditurës se aktgjykimi është përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 parag.2 pika (n) e

LPK-së. Sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit, dispozitivi i aktgjykimit të atakuar është mjaft i qartë, e në përputhje të plotë me arsyet e aktgjykimit, duke qenë kështu në harmoni logjike dhe juridike dispozitivi me arsyetimin. Gjykata ka arsyetuar të gjitha faktet vendimtare për themelësinë e kërkesëpadisë e në lidhshmëri me këtë ka arsyetuar mënyrën se si janë vërtetuar faktet dhe mënyrën se si i ka vlerësuar provat për secilin fakt të provuar.

Po ashtu gjendja faktike është vërtetuar në mënyrë të drejtë dhe faktet vendimtare nuk kanë qenë kontestuese. Nuk ka qenë kontestuese në mes palëve se paditësi është në marrëdhënie pune tek e paditura, përkatësisht në SHFMU “Mushnikova” në Mushnikovë, në Prizren, gjë e cila është vërtetuar me anë të vërtetimit me numër të referencës 37/2023, të datës 17.01.2023 e cila gjendet si provë në shkresat e lëndës, e po ashtu janë vërtetuar edhe ditët e pranisë së paditëses në punë për periudhën 01.01.2022 deri 31.08.2022, gjithsej 100 ditë, përmes vërtetimit të lëshuar nga institucioni në të cilin punon, e i cili gjendet në shkresat e lëndës.

Nuk qëndrojnë pretendimet ankimore se gjykata e shkallës së parë gabimisht ka aplikuar të drejtën materiale, kjo për arsye se me nenin 90 parag.1 të Ligjit të Punës 03/L-212, të datës 01.11.2010, përcaktohet se: *“Marrëveshja Kolektive mund të lidhet në mes: a) organizatës së punëdhënësve ose përfaqësuesit të tij, dhe b) organizatës së të punësuarve, ose kur nuk ekzistojnë organizata, marrëveshjen mund ta lidhin edhe përfaqësuesit e të punësuarve. Me parag.1 të këtij neni përcaktohet se Marrëveshja Kolektive mund të lidhet a) në nivel të vendit, b) në nivel të degës dhe c) nivel të ndërmarrjes. Me parag.3 të këtij neni përcaktohet se Marrëveshja Kolektive duhet të jetë në formë të shkruar, në gjuhën zyrtare të Republikës së Kosovës. Me parag.4 përcaktohet se Marrëveshja Kolektive vlen për ata punëdhënës dhe punëmarrës të cilët marrin përsipër detyrimet e përcaktuara me marrëveshjen e tillë kolektive”*.

Me nenin 35 par.7 të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë, të datës 22.01.2021 parashihet se *“Të punësuarve, u sigurohet kompensim për ushqim gjatë punës, për ditët e pranisë në punë. Vlera e kompensimit të ushqimit në punë, për një ditë pune është 2 (dy) euro për të punësuarit që kanë marrëdhënien e punës primare në institucione arsimore. Punëdhënësi i cili e ka të rregulluar ushqimin e të punësuarve, përmes restaurantit a kuzhinës, ose në një formë tjetër, nuk ka obligim kompensimin për ushqim”*. Edhe sa i përket vlerësimit të kohëzgjatjes së kontratës është bazuar në Mendimin Juridik të Gjykatës Supreme të Kosovës nr.40/2023, të datës 27.02.2023, ku është theksuar se *“Kontrata Kolektive e Arsimit në Kosovë e datës 18.04.2017, aplikohet në periudhën kohore nga data 18.04.2017 deri më 21.01.2021”*. Ndërsa, kjo gjykatë shton se për periudhën prej datës 22.01.2021 e deri më 31.08.2022, vlen dispozita e nenit 35 par.7 e Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë, të datës 22.01.2021 e cila në mënyrë të njëjtë ka paraparë kompensimin e punëtorëve për shujtat ditore. Andaj mbi bazën e të lartcekurave, kjo gjykatë gjeti se gjykata e shkallës së parë drejtë ka vendosur kur e ka aprovuar kërkesëpadinë e paditësit si të bazuar, për çka edhe vendosi që të njëjtin ta vërtetoj sikurse në dispozitivin e këtij aktgjykimi.

Nga arsyet e lartcekura, Gjykata e Apelit e aprovon në tërësi arsyetimin e aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë sa i përket vendosjes lidhur me aprovimin e kërkesëpadisë së paditëses që në emër të kompensimit të ushqimit ditor-shujtës, për periudhën për të cilën

paditësja kërkon kompensimin, t'ia kompensojë shumën e aprovuar si në dispozitiv të aktgjykimit të atakuar. Gjithashtu edhe për lartësinë e kërkesëpadisë gjykata e shkallës së parë ka vendosur drejtë dhe në mënyrë të ligjshme, pasi që në shkresat e lëndës ka pasur prova të mjaftueshme, andaj dhe u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Pretendimi ankimor i të paditurës se gjykata e shkallës së parë gabimisht dhe në mënyrë jo të plotë e ka konstatuar gjendjen faktike me rastin e nxjerrjes së aktgjykimit pasi që e paditura nuk është palë nënshkruese e Kontratës së Përgjithshme Kolektive dhe se paditëses nuk i takojnë benifitet nga Kontrata Kolektive, kjo gjykatë gjeti se një pretendim i tillë nuk është i bazuar, duke qenë se me nenin 90, paragraf 1 të Ligjit të Punës 03/L-212 të datës 01.11.2010, përcaktohet se: *“Marrëveshja Kolektive mund të lidhet në mes: a) organizatës së punëdhënësve ose përfaqësuesit të tij, dhe b) organizatës së të punësuarve ose kur nuk ekzistojnë organizata, marrëveshjen mund ta lidhin edhe përfaqësuesit e të punësuarve. Me paragrafin 1 të këtij neni përcaktohet se: “Marrëveshja Kolektive mund të lidhet a) të nivel të vendit, b) në nivel të degës dhe c) nivel të ndërmarrjes.” Me paragrafin 3 të këtij neni përcaktohet se: “Marrëveshja Kolektive duhet të jetë në formë të shkruar, në gjuhën zyrtare të Republikës së Kosovës.” Me paragrafin 4 përcaktohet se: “Marrëveshja Kolektive vlen për ata punëdhënës dhe punëmarrës të cilët marrin përsipër detyrimet e përcaktuara me marrëveshjen e tillë kolektive”.* Ndërsa në nenin 2, paragrafi 1.2 të Kontratës Kolektive e Arsimit në Kosovë të datës 22.01.2021, ndër të tjera thuhet se: *“Dispozitat e kësaj Kontrate Kolektive janë të zbatueshme për të gjithë punëdhënësit në sektorin e Arsimit, (Komunat-DKA, KD të Universiteteve e institucioneve të arsimit të lartë, MASHT-in etj.) në sektorin publik dhe institucionet edukativo-arsimore private në mbarë territorin e Republikës së Kosovës...”*, ndaj detyrimi për zbatimin e kësaj kontrate ka fuqinë ligjore.

Në këtë drejtim edhe vendimi për shpenzimet e procedurës është në përputhje me dispozita e LPK-së, dhe sa i përket lartësisë është në harmoni me tarifën e Odës së Avokatëve dhe tarifat për shpenzime gjyqësore. E drejta materiale është zbatuar në mënyrë të drejtë edhe sa i përket kërkesës aksesore përkitazi me kamatën.

Gjykata e Apelit me rastin e vendosjes i vlerësoi edhe të gjitha pretendimet e tjera ankimore, mirëpo të njëjtat nuk ishin me ndikim për një vendim ndryshe për çka edhe vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Nga arsyet e cekura Gjykata e Apelit, gjeti se gjykata e shkallës së parë në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme ka vendosur në këtë çështje juridike, prandaj në mbështetje të dispozitave nga neni 194, 195 par. 1 pika d) të LPK-së, lidhur me neni 200 të LPK-së, u vendosë si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË

Ac.nr.6798/23, datë 03.10.2024

**Kryetari i kolegjit - gjyqtari
Arsim Hamzaj**